



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1128 Prot.

Kuçovë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023

V E N D I M

Nr. 14 , datë 24 . 03 . 2023

PËR  
MIRATIMIN E BASHKËFINANCIMIT PËR PROJEKTIN E “ PËRMIRËSIMIT TË  
BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË  
PAFAVORIZUARA” PËR VITIN 2023.

Këshilli Bashkiak Kuçovë në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në pikën 2, të nenit 24, germa “k” e nenit 54 , të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 11 pika 1, germa b të ligjit nr.22 /2018 “ Për strehimin social”, dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 454 datë 03.07.2019 “ Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese, referuar shkresës ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me nr. 23964 Prot. datë 28.12.2022, protokolluar pranë institucionit tonë me nr.02 Prot. datë 04.01.2023 me lëndë: Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2023, nepërmjet së cilës janë publikuar afatet dhe termat e referencës për aplikime për fondet e investimeve.

V E N D O S I

1. Miratimin e kuotës së bashkëfincimit të shprehur në përqindje 20% dhe në 5 906 080 lekë për projektin Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara Kuçovë 2023.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kuçovë , Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit të Territorit dhe Koordinimit – Zhvillimit Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Ky vendim u miratua me 16 vota pro, — vota kundër, — vota abstenim.

**KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK**

**Migena Bullari**

